



**AUTO CLUB  
ALBANIA**

Automobile Club Albania  
Rr. "I. Qemali" Nr. 9, H. 2, Nj. A. 5, 1019 Tirana, Albania  
T: +355 4 2387011 F: +355 4 2387018,  
E: [info@aca.al](mailto:info@aca.al) /W: [www.aca.al](http://www.aca.al)

Datë: 02/092021

Nr. 24 Prot.

Drejtuar: Z. Eduart MERKAJ  
Drejtori i Departamentit për Kufirin dhe Emigracionin

Subjekti: Kërkesë për mbështetje për lehtësimin e procedurave për kalimin e kufirit të pilotëve pjesëmarrës në garën sportive ndërkombëtare me autovetura "Trofeu Skënderbej - Kruja Hill Climb 2021"

Të nderuar,

Klubi i Automobilit të Shqipërisë (ACA), me autoritetin e Federatës Shqiptare të Sporteve të Automobilizimit (FASA), do të organizojë në datat 11 Shtator - 12 Shtator 2021, aktivitetin e garës sportive ndërkombëtare të shpejtësisë me autovetura, "Trofeu Skënderbej - Kruja Hill Climb 2021". Ky është viti i 8-të që kjo garë ndërkombëtare zhvillohet në territorin e Bashkisë Krujë.

"Trofeu Skënderbej - Kruja Hill Climb 2020" është garë sportive me autovetura e regjistruar zyrtarisht në Kalendarin Kombëtar Sportiv të FASA e cila ka të drejtën e organizimit të saj.

Po ju paraqesim kërkesën për mbështetje për lehtësimin e procedurave më kalimin e kufirit të pilotëve, të cilët do të marrin pjesë në garën sportive automobilistike "Trofeu Skënderbej - Kruja Hill Climb 2021" në datat 11 Shtator - 12 Shtator 2021.

Me anë të kësaj shkrese, Ju kërkojmë paraprakisht mbështetje për lehtësimin e procedurave për kalimin e kufirit të garuesve, pjesëmarrës në këtë event nga data 10-13 Shtator 2021.

Në ditët në vijim do t'ju dërgojmë informacion për listën e pilotëve dhe mjeteve përkatëse shoqëruar nga pikat kufitare përmes të cilave ato do të futen në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Duke ju falënderuar paraprakisht për kohën Tuaj, mbetemi në dispozicionin për çdo informacion të mëtejshëm.

Me konsideratat më të mira,

Eridon LAMEBORSHI  
Sekretar i Përgjithshëm  
Auto Club Albania



MEMBER OF

